



**BULETINI PERIODIK I
PRAKTIKËS GJYQËSORE
PERIODIČNI BILTEN
SUĐSKE PRAKSE**



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

**TETOR - DHJETOR
OKTOBAR - DECEMBAR
2023**

IV

**Buletini periodik i praktikës gjyqësore
të Gjykatës Kushtetuese**
(Tetor - Dhjetor 2023)

Buletini periodik i praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese përmban përmbledhjen e aktgjykimeve dhe aktvendimeve me rëndësi dhe interes të veçantë, të cilat janë publikuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) gjatë periudhës së fundit tre (3) mujore.

Me qëllimin për ta bërë sa më të qartë për lexuesit natyrën e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, aktgjykimet dhe aktvendimet janë klasifikuar sipas pretendimeve të bazuara në nenet specifike të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).

Buletini periodik i praktikës gjyqësore është një dokument që publikohet në baza periodike dhe është përgatitur nga Sekretaria e Gjykatës vetëm për çështje informative.

Tekstet e plota të aktgjykimeve dhe të aktvendimeve të përfshira në këtë Buletin janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe mund t'i gjeni të publikuara edhe në ueb-faqen e Gjykatës Kushtetuese: www.gjk-ks.org

Për të pranuar Buletinin periodik të praktikës gjyqësore në postën tuaj elektronike, ju lutemi të regjistrohemi në ueb-faqen e Gjykatës:

www.gjk-s.org/publication_category/buletini-periodik

Vërejtje: Kushdo që dëshiron të kopjojë, përkthejë apo shfrytëzojë për qëllime të tjera të gjitha ose një pjesë të informacioneve të përmbajtura në Buletin, duhet të kontaktojë Sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese për udhëzime të mëtejshme.

**Periodični bilten sudske
prakse Ustavnog suda**
(oktobar – decembar 2023. godine)

Periodični bilten sudske prakse Ustavnog suda sadrži sažetke presuda i rešenja od posebnog značaja i interesa, koje je Ustavni sud Republike Kosovo (u daljem tekstu: Sud) objavio u poslednja tri (3) meseca.

Kako bi se čitaocima učinila što jasnijom priroda odluka Ustavnog suda, presude i rešenja su klasifikovani prema navodima zasnovanim na određenim članovima Ustava Republike Kosovo (u daljem tekstu: Ustav).

Periodični bilten sudske prakse je dokument koji se objavljuje periodično, a Sekretarijat suda ga priprema samo u informativne svrhe.

Kompletni tekstovi presuda i rešenja sadržanih u ovom Biltenu objavljeni su u Službenom listu Republike Kosovo, a mogu se naći i na internet stranici Ustavnog suda:

www.gjk-ks.org

Da biste primali Periodični bilten sudske prakse na svoju adresu elektronske pošte, molimo vas registrujte se na internetstranici Suda:

https://gjk-ks.org/sr/publication_category/periodicni-bilten/

Napomena: Svako ko želi da kopira, prevede ili za druge svrhe koristi sve ili deo informacija sadržanih u ovom Biltenu treba da kontaktira Sekretarijat Ustavnog suda za dalja uputstva.

"Perandori Justinian" nr. 44, 10 000 Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 60 61 62
Mob: +383(0) 45 200 595; +383(0) 45 200 576
Fax: +383(0) 38 60 61 70
Email: gjkata.kushtetuese@gjk-ks.org
©Gjykata Kushtetuese 2023

Tabela e përmbajtjes/Pregled sadržaja

I - Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

I - Član 31 [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje]

(i) E drejta për qasje në drejtësi

(i) Pravo na pristup pravdi

- Refuzimi i padisë së parashtruesit të kërkesës nga gjykatat e rregullta pasi e njëjta nuk është paraqitur brenda afatit ligjor, si dhe refuzimi i kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme, nuk e cenon të drejtën për qasje në drejtësi, si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë, nëse arsyetimet e gjykatave të rregullta ngërthejnë formalizëm të tepruar dhe/ose arbitraritet në interpretimin e ligjeve të aplikueshme, pasi palët bartin përgjegjësinë për respektimin e kërkesave të përcaktuara në ligjet e aplikueshme, përkatësisht të ndjekin afatet dhe procedurat përkatëse sipas përcaktimeve ligjore: - *mos shkelje e të drejtave kushtetuese*
- Odbijanje tužbe podnosioca zahteva od strane redovnih sudova, pošto ista nije podneta u zakonskom roku, kao i odbijanje zahteva za vraćanje u pređašnje stanje ne predstavlja povredu prava na pristup pravdi, kao sastavnog dela pravičnog suđenja, ako obrazloženje redovnih sudova uključuje preteranu formalnost i/ili proizvoljnost u tumačenju važećih zakona, budući da strane snose odgovornost za poštovanje uslova utvrđenih u važećim zakonima, odnosno da poštuju relevantne rokove i postupke prema zakonskim odredbama: - *nema povrede ustavnih prava*

KI90/23, Parashtrues: Shqipdon Fazliu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [ARJ.nr.114/2022], të 23 dhjetorit 2022 ndërlidhur me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [AA.nr.650/2022], të 1 shtatorit 2022 dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë [A.nr.1875/22], të 2 gushtit 2022..... 6

KI90/23, podnosilac zahteva: Shqipdon Fazliu, ocena ustavnosti presude [ARJ. br. 114/2022] Vrhovnog suda Republike Kosovo od 23. decembra 2022. godine u vezi sa rešenjem [AA. br. 650/2022] od 1. septembra 2022. godine Apelacionog suda i rešenjem [A. br. 1875/22] od 2. avgusta 2022. godine Osnovnog suda u Prištini.....6

(i) E drejta për një proces të rregullt

(i) Pravo na pravično suđenje

- E drejta për t'u informuar për ndryshim dhe zgjerim të aktakuzës, si dhe ajo për ballafaqim të dëshmitarëve dhe dëgjim të dëshmitarëve në dobi të parashtruesit të kërkesës, si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë, nuk cenohen nëse (i) prokurori me kohë ka njoftuar mbrojtësin e parashtruesit të kërkesës lidhur me zgjerimin e aktakuzës; (ii) zgjerimi i aktakuzës kundër parashtruesit të kërkesës nuk ka ndryshuar kualifikimin e veprës penale dhe nuk ka ndryshuar rolin e tij në kryerjen e veprës penale; (iii) gjykatat e rregullta kanë shpjeguar se dëshmitarët janë ballafaquar me parashtruesin e kërkesës dhe/ose mbrojtjen e tij; (iv) gjykatat e rregullta nuk kanë mohuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për të propozuar dëshmitarë të rinj; si dhe (v) gjykatat e rregullta kanë dëgjuar edhe dëshmitarët në dobi të parashtruesit të kërkesës: - *mos shkelje e të drejtave kushtetuese*
- Pravo na informisanje o izmeni i proširenju optužnice, kao i pravo na suočavanje sa svedocima i saslušanje svedoka u korist podnosioca zahteva, kao sastavni deo pravičnog suđenja, nisu povređena, ako (i) je tužilac blagovremeno obavestio branioca podnosioca zahteva o proširenju optužnice; (ii) proširenje optužnice protiv podnosioca zahteva nije promenilo kvalifikaciju krivičnog dela i nije promenilo njegovu ulogu u izvršenju krivičnog

dela; (iii) redovni sudovi su objasnili da su se svedoci suočili sa podnosiocem zahteva i/ili njegovom odbranom; (iv) redovni sudovi nisu uskratili pravo podnosioca zahteva da predlaže nove svedoke; i (v) redovni sudovi su takođe saslušali svedoke u korist podnosioca zahteva: - *nema povrede ustavnih prava*

KI74/22, Parashtrues: Zoran Đokić, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [Pml.nr.19/2022], të 15 shkurtit 2022.....13

KI74/22, podnosilac zahteva: Zoran Đokić, ocena ustavnosti presude Vrhovnog suda [Pml. br. 19/2022] od 15. februara 2022. godine.....13

II - Neni 12 [Pushteti Lokal]

Neni 123 [Parimet e Përgjithshme]

Neni 124 [Organizimi dhe Funkcionimi i Vetëqeverisjes Lokale]

II - Član 12. [Lokalna vlast]

Član 123. [Osnovna načela]

Član 124. [Organizovanje i funkcionisanje lokalne samouprave]

(i) *Ligji nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme*

(i) *Zakona br. 08/L-224 o izmeni i dopuni Zakona br. 06/L-005 o porezu na nepokretnu imovinu*

- Dispozita ligjore e cila përcakton (i) bazën ligjore sipas të cilës mund të falet tatimi në pronën e paluajtshme dhe saktëson lartësinë maksimale të faljes së këtij tatimi dhe afatin përkatës kohor brenda të cilit mund të merret vendimi për faljen e tatimit në pronën e paluajtshme; përderisa (ii) kompetencën për një vendimmarrje të tillë ia përcakton kuvendeve përkatëse komunale, nuk cenon përgjegjësitë komunale apo nuk zvogëlon të hyrat e komunës të garantuara me paragrafin 2 të nenit 12 [Pushteti Lokal], paragrafin 1 të nenit 123 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 2 dhe 5 të nenit 124 [Organizimi dhe Funkcionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës:
- *mos shkelje e të drejtave kushtetuese*
- Zakonska odredba koja definiše (i) pravni osnov po kome se može oprostiti porez na nepokretnu imovinu i precizira maksimalni iznos poreskog oslobođenja i relevantni rok u kome se može doneti odluka o oslobođanju od poreza na nepokretnu imovinu; dok (ii) nadležnost za takvo odlučivanje dodeljuje relevantnim skupštinama opština, ne krši opštinske odgovornosti niti umanjuje prihode opštine zagwarantovane stavom 2 člana 12. [Lokalna vlast], stavom 1 člana 123. [Osnovna načela] i stavovima 2 i 5 člana 124. [Organizovanje i funkcionisanje lokalne samouprave] Ustava:
- *nema povrede ustavnih prava*

KO 177/23, Parashtrues: Komuna e Prizrenit, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 5 të Ligjit nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme].....16

KO 177/23, podnosilac zahteva: Opština Prizren, ocena ustavnosti člana 5. Zakona br. 08/L-224 o izmeni i dopuni Zakona br. 06/L-005 o porezu na nepokretnu imovinu.....16

III - Neni 7 [Vlerat], Neni 10 [Ekonomia], Neni 119 [Parimet e Përgjithshme]

III - Član 7. [Vrednosti], član 10. [Ekonomija], član 119. [Osnovna načela]

(i) *Ligji nr. 08/L-179 për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të Destabilizimit në Treg*

(i) *Zakon br. 08/L-179 o privremenim merama osnovnih proizvoda u posebnim slučajevima destabilizacije na tržištu*

- Kompetenca e Ministrit dhe/ose Kryeministrit për të vendosur masa të përkohshme mbrojtëse dhe të cilat kufizojnë lirinë e veprimtarisë ekonomike të operatorëve ekonomikë në Republikën e Kosovës, nuk përkon me standardin kushtetues të vendimmarrjes së pavarur lidhur me rregullimin e tregut, marrë parasysh që paragrafi 5 i nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës saktësisht përcakton që Republika e Kosovës do të themelojë “organe të pavarura” për rregullimin e tregut atëherë kur vetë tregu nuk mundet që në masë të mjaftueshme të mbrojë interesin publik: – *shkelje e të drejtave kushtetuese*
- Nadležnost ministra i/ili premijera da uspostavlja privremene zaštitne mere i koje ograničavaju slobodu ekonomske delatnosti ekonomskih operatera u Republici Kosovo, ne poklapa se sa ustavnim standardom nezavisnog odlučivanja u vezi sa regulisanjem tržišta, s obzirom da je u stavu 5, člana 119. [Osnovna načela] Ustava precizno određeno da će Republika Kosovo osnovati “nezavisne organe” za regulisanje tržišta, onda kada samo tržište ne može dovoljno da zaštiti javni interes: - *povreda ustavnih prava*

KO 173/22, Parashtrues: Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-179 për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të Destabilizimit në Treg21

KO173/22, podnosilac zahteva: Arben Gashi i 9 (devet) drugih poslanika Skupštine Republike Kosovo, ocena ustavnosti Zakona br. 08/L-179 o privremenim merama osnovnih proizvoda u posebnim slučajevima destabilizacije na tržištu21

**Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë
dhe të Paanshëm]**

KI90/23, Parashtrues: Shqipdon Fazliu: Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [ARJ.nr.114/2022], të 23 dhjetorit 2022, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ndërlidhur me Aktvendimin [AA.nr.650/2022], e 1 shtatorit 2022, të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimin [A.nr.1875/22], e 2 gushtit 2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Refuzimi i padisë së parashtruesit të kërkesës nga gjykatat e rregullta, pasi e njëjta nuk është paraqitur brenda afatit ligjor, si dhe refuzimi i kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme, nuk e cenon të drejtën për qasje në drejtësi, si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë, nëse arsyetimet e gjykatave të rregullta ngërthejnë formalizëm të tepruar dhe/ose arbitraritet në interpretimin e ligjeve të aplikueshme, pasi palët bartin përgjegjësinë për respektimin e kërkesave të përcaktuara në ligjet e aplikueshme, përkatësisht të ndjekin afatet dhe procedurat përkatëse sipas përcaktimeve ligjore: - *mos shkelje e të drejtave kushtetuese*

Faktet

Aktgjykimi i Gjykatës sqaron që në rrethanat e rastit konkret, para Gjykatës janë kontestuar vendimet përkatëse të gjykatave të rregullta, të cilat e kanë refuzuar si të pasafatshme padinë për inicimin e konfliktit administrativ të parashtruesit të kërkesës kundër vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPK), të 6 prillit 2022, lidhur me propozimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit të Republikës së Kosovës. Aktgjykimi rikujton që thelbi i rrethanave të këtij rasti ndërlidhet me procesin e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit, përmes konkursit të shpallur më 14 janar 2022, si rrjedhojë e të cilit, KPK e kishte votuar dhe propozuar për emërim Presidentes së Republikës së Kosovës kandidatin për Kryeprokuror të Shtetit. Parashtruesi i kërkesës kishte kontestuar vlerësimin e Panelit vlerësues të KPK-së, sipas të cilit, i njëjti ishte radhitur i dyti, duke iu drejtuar fillimisht Komisionit për rishqyrtim brenda KPK-së. Ky komision i kishte

**Çlan 31. [Pravo na pravično i
nepristrasno suđenje]**

KI90/23, podnosilac zahteva: Shqipdon Fazliu, ocena ustavnosti presude [ARJ. br. 114/2022] Vrhovnog suda Republike Kosovo od 23. decembra 2022. godine u vezi sa rešenjem [AA. br. 650/2022] od 1. septembra 2022. godine Apelacionog suda i rešenjem [A. br. 1875/22] od 2. avgusta 2022. godine Osnovnog suda u Prištini.

Odbijanje tužbe podnosioca zahteva od strane redovnih sudova, pošto ista nije podneta u zakonskom roku, kao i odbijanje zahteva za vraćanje u pređašnje stanje ne predstavlja povredu prava na pristup pravdi, kao sastavnog dela pravičnog suđenja, ako obrazloženje redovnih sudova uključuje preteranu formalnost i/ili proizvoljnost u tumačenju važećih zakona, budući da strane snose odgovornost za poštovanje uslova utvrđenih u važećim zakonima, odnosno da poštuju relevantne rokove i postupke prema zakonskim odredbama: - *nema povrede ustavnih prava.*

Činjenice

Presuda Suda pojašnjava da su, u okolnostima konkretnog slučaja pred Sudom, osporene gore navede odluke redovnih sudova, kojima je odbijena kao neblagovremena tužba za pokretanje upravnog spora podnosioca zahteva protiv odluka Tužilačkog saveta Kosova (u daljem tekstu: TSK), od 6. aprila 2022. godine, u vezi sa predlaganjem kandidata za glavnog državnog tužioca Republike Kosovo. Presudom se podseća da je suština okolnosti ovog slučaja povezana sa procesom izbora glavnog državnog tužioca, na osnovu konkursa raspisanog 14. januara 2022. godine, kao rezultat kojeg je TSK izglasao i predložio predsednici Republike Kosovo za imenovanje kandidata za glavnog državnog tužioca. Podnosilac zahteva je osporio vrednovanje Komisije za evaluaciju TSK-a, prema kojem je on zauzeo drugo mesto, na taj način što se prvo obratio Komisiji za ponovno razmatranje pri TSK-u. Ova Komisija je

shqyrtuar pretendimet e tij, duke (i) refuzuar si të pabazuara pretendimet përkatëse lidhur me moszbatim të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial dhe Rregullores nr. 06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës; por duke (ii) rekomanduar që të miratohen pjesërisht kundërshtimet e parashtruesit të kërkesës, vetëm sa i përket pretendimit për poentim, me propozimin që anëtarët e Panelit vlerësues të rishikojnë edhe një herë procesin rreth arsytimit të poentimit përkatës. Më 6 prill 2022, KPK kishte nxjerrë dy vendime, përkatësisht (i) Vendimin [Nr.474/2022], e KPK-së për refuzimin e Raportit të Komisionit për rishqyrtim; dhe (ii) Vendimin [KPK/Nr.475/2022] e KPK-së për propozimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit. Më 28 prill 2022, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të lartcekura në Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit, përmes Aktvendimit për papranueshmëri në rastet e bashkuara KI57/22 dhe KI79/22, më 4 korrik 2022, kishte vendosur se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme për shqyrtim në merita për arsye procedurale, përkatësisht sepse kërkesa e parashtruar nuk plotësonte kriterin kushtetues të shterimit të mjeteve juridike të përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës.

Aktgjykimi i Gjykatës më tej sqaron që më 28 korrik 2022, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Themelore padi për iniciimin e konfliktit administrativ me propozimin e sigurimit të kërkesëpadisë me masën e përkohshme, përkatësisht me kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të kontestuara të KPK-së. Më saktësisht, para Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës kishte ngritur pretendime lidhur me (i) afatshmërinë e padisë përkatëse; dhe (ii) ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e vendimeve të kontestuara të KPK-së. Përkitazi me çështjen e parë, përkatësisht afatshmërinë e kërkesës, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, pretendonte që padia e tij duhet të konsiderohej e afatshme, bazuar në paragrafin 2 të nenit 28 (pa titull) dhe nenin 63 (pa titull) të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative dhe/ose që afati për iniciimin e konfliktit

razmotrila njegove navode, (i) odbivši kao neosnovane relevantne navode koji se odnose na nesprovođenje Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom savetu i Pravilnika br. 06/2019 o imenovanju glavnog državnog tužioca i glavnih tužilaca u tužilaštvima Republike Kosovo; ali (ii) preporučivši da se delimično usvoje prigovori podnosioca zahteva samo u odnosu na navod o bodovanju, sa predlogom da članovi Komisije za evaluaciju još jednom preispitaju proces u pogledu obrazloženja datog bodovanja. Dana 6. aprila 2022. godine, TSK je doneo dve odluke, odnosno (i) odluku [br. 474/2022] TSK-a o odbijanju izveštaja Komisije za ponovno razmatranje; i (ii) odluku [KPK/br. 475/2022] TSK-a o predlaganju kandidata za glavnog državnog tužioca. Podnosilac zahteva je 28. aprila 2022. godine podneo Ustavnom sudu zahtev za ocenu ustavnosti gore navedenih odluka. Ustavni sud je rešenjem o neprihvatljivosti u spojenim slučajevima KI57/22 i KI79/22, dana 4. jula 2022. godine, odlučio da je zahtev podnosioca zahteva neprihvatljiv za meritorno razmatranje iz procesnih razloga, odnosno zbog toga što zahtev nije ispunio ustavni kriterijum iscrpljenosti pravnih sredstava utvrđenih stavom 7. člana 113. Ustava.

Presudom Suda je dalje pojašnjeno da je podnosilac zahteva, dana 28. jula 2022. godine, podneo Osnovnom sudu tužbu za pokretanje upravnog spora, sa predlogom obezbeđenja tužbenog zahteva privremenom merom, odnosno zahtevom za odlaganje izvršenja osporenih odluka TSK-a. Konkretnije, podnosilac zahteva je pred Osnovnim sudom izneo navode koji su se odnosili na (i) blagovremenost predmetne tužbe; i (ii) zakonitost i ustavnost osporenih odluka TSK-a. Što se tiče prvog pitanja, odnosno blagovremenosti zahteva, podnosilac zahteva je, između ostalog, tvrdio da se njegova tužba morala smatrati blagovremenom na osnovu stava 2. člana 28. (bez naslova) i člana 63. (bez naslova) Zakona br. 03/L-202 o upravnim sporovima i/ili da se rok za pokretanje upravnog spora mora vratiti u predašnje stanje na osnovu članova 129. (bez naslova) i 130. (bez naslova) Zakona br. 03/L-006 o parničnom postupku. Prema

administrativ duhet të kthehej në gjendjen e mëparshme bazuar në nenet 129 (pa titull) dhe 130 (pa titull) të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore. Sipas parashtruesit të kërkesës dhe bazuar në nenet e lartcekura, padia në Gjykatën Themelore duhej të konsiderohej si e paraqitur brenda afatit, sepse edhe pse nuk i ishte paraqitur me kohë Gjykatës Themelore, e njëjta i ishte paraqitur me kohë “*organit jo-kompetent*”, përkatësisht Gjykatës Kushtetuese, si rezultat i “*mos dijës apo e gabimit të hapur të paraqitësit*”, përkatësisht të parashtruesit të kërkesës. Kjo, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera, sepse i njëjti kishte pritje që në rastin e tij Gjykata Kushtetuese do të vendoste njëjtë si në rastet KI99/14 dhe KI100/14, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së propozimit të Kryeprokurorit të Shtetit nga KPK në vitin 2014. Ndërsa, përkitazi me çështjen e dytë, përkatësisht meritat e padisë përkatëse, parashtruesi i kërkesës, në esencë, kishte ngritur pretendime lidhur me (i) ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e Rregullores së KPK-së për Emërimin e Kryeprokurorit; dhe (ii) mënyrën e poentimit nga anëtarët e Panelit vlerësues të KPK-së, duke kontestuar, ndër të tjera, zbritjen e pikëve nga ato maksimale sipas kriterëve të vlerësimit të përcaktuara përmes Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorit, pa arsyetimin e nevojshëm dhe/ose përmbajtjen e arsyetimit përkatës.

Gjykatat e rregullta, përkatësisht Gjykata Themelore, e Apelit dhe Supreme, refuzuan padinë e parashtruesit të kërkesës si të pasafatshme, duke theksuar, ndër të tjera, që bazuar në Ligjin për Konfliktet Administrative (i) padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës ose nëse akti administrativ nuk i është dorëzuar brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e dorëzimit të aktit administrativ palës në dobi të së cilës është nxjerrë akti; ndërsa (ii) në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës, padia lidhur me vendimet e KPK-së, të 6 prillit 2022, është paraqitur më 28 korrik 2022 dhe për pasojë, kjo padi është paraqitur jashtë afateve të përcaktuara me ligjin e aplikueshëm, përkatësisht Ligjin për Konfliktet Administrative. Në kontekst të pretendimit të parashtruesit të kërkesës, që padia do të duhej të konsiderohej

navodima podnosioca zahteva i na osnovu gore navedenih članova, za tužbu Osnovnom sudu se moralo smatrati da je podneta u roku zbog toga što je ista, iako nije blagovremeno podneta Osnovnom sudu, bila blagovremeno podneta “*nenadležnom organu*”, odnosno Ustavnom sudu, usled “*neznanja ili očigledne omaške podnosioca*”, odnosno podnosioca zahteva. To, prema navodu podnosioca zahteva, između ostalog, zbog toga što je, isti imao očekivanja da će Ustavni sud u njegovom slučaju odlučiti isto kao što je odlučio u slučaju KI99/14 i KI100/14 u vezi sa ocenom ustavnosti predloga za glavnog državnog tužioca od strane TSK-a u 2014. godini. Što se pak tiče drugog pitanja, odnosno osnovanosti predmetne tužbe, podnosilac zahteva je u suštini izneo navode koji su se odnosili na (i) zakonitost i ustavnost Pravilnika TSK-a o imenovanju glavnog tužioca; i (ii) način bodovanja od strane članova Komisije za evaluaciju TSK-a, osporivši pri tom, između ostalog, smanjenje bodova od maksimalno dozvoljenih bodova shodno kriterijumima vrednovanja utvrđenih Pravilnikom o imenovanju glavnog tužioca, bez potrebnog obrazloženja i/ili sadržaja tog obrazloženja.

Redovni sudovi, odnosno Osnovni, Apelacioni i Vrhovni sud, odbili su tužbu podnosioca zahteva kao neblagovremenu, navodeći, između ostalog, da se na osnovu Zakona o upravnim sporovima, (i) tužba podnosi u roku od trideset (30) dana od dana kada je konačni upravni akt dostavljen stranci; ili ako upravni akt nije dostavljen, u roku od šezdeset (60) dana od dana dostavljanja upravnog akta stranci u čiju korist je donesen akt; dok je (ii) u okolnostima slučaja podnosioca zahteva, tužba u odnosu na odluke TSK-a od 6. aprila 2022. godine, podneta 28. jula 2022. godine i da je samim tim ova tužba podneta van rokova propisanih važećim zakonom, odnosno Zakonom o upravnim sporovima. U kontekstu navoda podnosioca zahteva, da se tužba morala smatrati blagovremenom na osnovu člana 28. Zakona o upravnim sporovima i članova 129. i 130. Zakona o parničnom postupku zbog toga što je usled “*neznanja ili očigledne omaške podnosioca*” tužba predata “*nenadležnom organu*”, odnosno Ustavnom

e afatshme bazuar në nenin 28 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenet 129 dhe 130 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, sepse si pasojë e “*mos dijës apo gabimit të hapur të paraqitësit*”, padia i ishte dorëzuar “*organit jo-kompetent*”, përkatësisht Gjykatës Kushtetuese, gjykatat e rregullta, në esencë, theksuan që këto dispozita nuk janë të aplikueshme në rrethanat e rastit përkatës. Kjo, ndër të tjera, sepse për të qenë i aplikueshëm neni 28 i Ligjit për Konfliktet Administrative, përkatësisht për t’u konsideruar padia përkatëse e afatshme, duhet të plotësohen dy kushte kumulative, përkatësisht që (i) padia të jetë dorëzuar para “*organit jo-kompetent*” si pasojë e “*mos dijës apo e gabimit të hapur të paraqitësit*”; dhe (ii) të ketë “*arritur*” në gjykatën kompetente pas skadimit të afatit për paraqitjen e padisë. Sipas sqarimeve të dhëna nga gjykatat e rregullta, në rrethanat e rastit konkret (i) parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese si rezultat i “*mos dijës apo e gabimit të hapur*” të tij sepse i njëjti, në këtë gjykatë ka dorëzuar kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të KPK-së; (ii) Gjykata Kushtetuese nuk mund të cilësohet si “*organ jo-kompetent*” për qëllime të këtij neni, sepse e njëjta ka vendosur lidhur me kërkesën e parashtruesit të kërkesës; (iii) padia e dorëzuar në “*organin jo-kompetent*” duhet të ketë “*arritur*” në Gjykatën Themelore pas afatit përkatës, ndërsa Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencën për të referuar/dorëzuar rastin në Gjykatën Themelore; dhe për më tepër (iv) bazuar në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës, përkatësisht dispozitat relevante të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjin për Procedurën Kontestimore, afatet për iniciimin e konfliktit administrativ dhe gjykata me kompetencë për të shqyrtuar të njëjtin, përkatësisht Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore, janë qartësisht të përcaktuara. Në fund, gjykatat e rregullta gjithashtu theksuan që nenet 129 dhe 130 të Ligjit për Procedurën Kontestimore lidhur me kthimin në gjendjen e mëparshme, janë të aplikueshme për afatet procedurale gjatë shqyrtimit procedural të një rasti dhe nuk vlejnë për rivendosjen e afatit ligjor për paraqitjen e

sudu, redovni sudovi su, u suštini, istakli da ove odredbe nisu primenljive u okolnostima datog slučaja. To, između ostalog, zbog toga što, da bi član 28. Zakona o upravnim sporovima bio primenljiv, odnosno da bi se predmetna tužba smatrala blagovremenom, moraju biti ispunjena dva kumulativna uslova, odnosno (i) da je tužba predata “*nenadležnom organu*” usled “*neznanja ili očigledne omaške podnosioca*” i (ii) da je “*stigla*” u nadležni sud po isteku roka za podnošenje tužbe. Prema pojašnjenjima koje su dali redovni sudovi, u okolnostima konkretnog slučaja, (i) podnosilac zahteva nije podneo zahtev Ustavnom sudu kao rezultat njegovog “*neznanja ili očigledne omaške*” jer je isti ovom sudu podneo zahtev za ocenu ustavnosti odluka TSK-a; (ii) Ustavni sud se ne može okvalifikovati kao “*nenadležan organ*” u smislu ovog člana jer je isti odlučio povodom zahteva podnosioca zahteva; (iii) tužba koja je predata “*nenadležnom organu*” je morala “*stići*” Osnovnom sudu nakon datog roka, dok Ustavni sud nema nadležnost da upućuje/dostavlja slučaj Osnovnom sudu; a povrh svega, (iv) na osnovu važećih zakona Republike Kosovo, odnosno relevantnih odredbi Zakona o upravnim sporovima i Zakona o parničnom postupku, rokovi za pokretanje upravnog spora i sud koji je nadležan za njegovo razmatranje, odnosno departman za upravna pitanja, su jasno utvrđeni. Na kraju, redovni sudovi su takođe istakli da su članovi 129. i 130. Zakona o parničnom postupku u vezi sa vraćanjem u predašnje stanje primenljivi za procesne rokove prilikom proceduralnog razmatranja slučaja i ne važe za vraćanje zakonskog roka za podnošenje tužbe, kako tvrdi podnosilac zahteva u okolnostima konkretnog slučaja.

Žalba podnosioca zahteva

Podnosilac zahteva je pred Sudom osporio donošenje odluka redovnih sudova, navodeći da su iste, između ostalog, donete uz povredu njegovog prava na pristup pravdi, zagarantovanog članom 31. Ustava u vezi sa članom 6. Evropske konvencije o ljudskim pravima. Podnosilac zahteva, između ostalog, ističe (i) da je prvi zahtev koji je upućen Ustavnom sudu bez iscrpljivanja pravnih sredstava propisanih

padisë, siç pretendon parashtuesi i kërkesës në rrethanat e rastit konkret.

Ankesa e parashtuesit të kërkesës

Parashtuesi i kërkesës, para Gjykatës kontestoi vendimmarrjen e gjykatave të rregullta, duke pretenduar që të njëjtat janë nxjerrë, ndër të tjera, në cenim të së drejtës së tij për qasje në drejtësi të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Parashtuesi i kërkesës, ndër të tjera, thekson që (i) kërkesa e parë e dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese, pa i shteruar mjetet juridike të përcaktuara me ligj, është dorëzuar bazuar në praktikën paraprahe të kësaj Gjykate, respektivisht bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës në rastet KI99/14 dhe KI100/14, por edhe në rastet KI34/17 e KI55/17, përmes të cilave ishte vlerësuar kushtetutshmëria e zgjedhjes së Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe të Apelit, respektivisht; dhe për pasojë, kishte pritje të arsyeshme që Gjykata Kushtetuese do të trajtonte edhe kërkesën e tij për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara të KPK-së; dhe (ii) pas vendimmarrjes nga Gjykata Kushtetuese në rastet KI57/22 dhe KI79/22, i njëjti i është drejtuar Gjykatës Themelore përmes inicimit të konfliktit administrativ me padi, duke pretenduar, ndër të tjera, që padia e tij në Gjykatën Themelore, bazuar në dispozitat e ligjit të aplikueshëm duhet të trajtohet si e afatshme, sepse si pasojë e “*mos dijës apo gabimit të hapur të paraqitësit*”, kërkesa për vlerësimin e vendimeve të kontestuara të KPK-së i është dorëzuar “*organit jo-kompetent*”, përkatësisht Gjykatës Kushtetuese dhe që për pasojë ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, bazuar në të cilat, Gjykata Themelore duhet të kishte lejuar kthimin në gjendjen e mëparshme për afatin e inicimit të konfliktit administrativ.

Gjetjet e Gjykatës

Në trajtimin e pretendimeve të parashtuesit të kërkesës, Aktgjykimi fillimisht sqaron që (i) për dallim nga rastet KI57/22 dhe KI79/22, përmes të cilave janë kontestuar vendimet përkatëse të KPK-së dhe është kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë si dhe shpallja e tyre në kundërshtim me Kushtetutën; në rrethanat e rastit konkret

zakonom, podnet na osnovu ranije prakse tog Suda, odnosno na osnovu presude Suda u slučajevima KI99/14 i KI100/14, ali i u slučajevima KI34/17 i KI55/17, kojima je ocenjena ustavnost izbora predsednika Vrhovnog i Apelacionog suda, respektivno; i da je kao rezultat toga, imao opravdano očekivanje da će Ustavni sud razmotriti i njegov zahtev za ocenu ustavnosti osporenih odluka TSK-a; i (ii) nakon donošenja odluke od strane Ustavnog suda u slučaju KI57/22 i KI79/22, isti se obratio Osnovnom sudu tužbom za pokretanje upravnog spora, navodeći, između ostalog, da se njegova tužba Osnovnom sudu, na osnovu odredbi važećeg zakona, mora smatrati blagovremenom, zbog toga što je usled “*neznanja ili očigledne omaške podnosioca*”, zahtev za ocenu osporenih odluka TSK-a podnet “*nenadležnom organu*”, odnosno Ustavnom sudu i da kao rezultat toga, postoje opravdani razlozi na osnovu kojih je Osnovni sud morao da dozvoli vraćanje u pređašnje stanje za rok za pokretanje upravnog spora.

Nalazi Suda

Prilikom razmatranja navoda podnosioca zahteva, u presudi je najpre pojašnjeno (i) da za razliku od slučaja KI57/22 i KI79/22 u kojem su osporene relevantne odluke TSK-a i traženo da se oceni njihova ustavnost kao i da budu proglašene suprotnim Ustavu; u okolnostima konkretnog slučaja se (ii) pred Sudom osporava presuda Vrhovnog suda, kojom je potvrđeno odlučivanje Apelacionog i Osnovnog suda o neblagovremenosti tužbe podnosioca zahteva u vezi sa pokretanjem upravnog spora protiv osporenih odluka TSK-a, sa zahtevom da se iste, odnosno odluke redovnih sudova proglase suprotnim Ustavu i da se ocena odluka TSK-a koje se odnose na predlaganje glavnog državnog tužioca vrati Osnovnom sudu na ponovno odlučivanje.

U presudi se najpre ističe da su sva potrebna pojašnjenja o proglašenju neprihvatljivim, prvog zahteva podnosioca zahteva usled neispunjavanja ustavne obaveze o iscrpljivanju zakonom propisanih pravnih sredstava, data u rešenju o neprihvatljivosti u slučaju KI57/22 i KI79/22, objavljene 25 jula 2022. godine. Dok, pri oceni ustavnosti presude Vrhovnog suda,

(ii) para Gjykatës, kontestohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, përmes të cilit është konfirmuar vendimmarrja e Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore, lidhur me pasafatshmërinë e padisë së parashtruesit të kërkesës lidhur me iniciimin e konfliktit administrativ kundër vendimeve të kontestuara të KPK-së, me kërkesën që të njëjtat, përkatësisht vendimet e gjykatave të rregullta, të shpallen në kundërshtim me Kushtetutën dhe që vlerësimi i vendimeve të KPK-së përkritazi me propozimin e Kryeprokurorit të Shtetit, të kthehet në rivendosje në Gjykatën Themelore.

Aktgjykimi fillimisht nënvizon që të gjitha sqarimet e nevojshme përkritazi me shpalljen e papranueshme të kërkesës së parë të parashtruesit për shkak të mospërbushjes së detyrimit kushtetues për shterimin e mjeteve juridike të përcaktuara me ligj, janë dhënë në Aktvendimin për Papranueshmëri në rastet KI57/22 dhe KI79/22, të publikuara më 25 korrik 2022. Ndërsa, në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të kontestuar në rastin konkret, Aktgjykimi i Gjykatës vlerëson pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me cenimin e të drejtës së tij për qasje në drejtësi si rezultat i vendimeve të gjykatave të rregullta, në bazë të të cilave, iniciimi i konfliktit administrativ kundër vendimeve të kontestuara të KPK-së, është shpallur i pasafatshëm. Në këtë kontekst, Aktgjykimi fillimisht shtjellon (i) parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën për qasje në drejtësi, të zhvilluara nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ajo e Gjykatës, me theks në të gjitha ato raste në të cilat është trajtuar cenimi ose jo i të drejtës për qasje në drejtësi, si rezultat i interpretimit/aplikimit të afateve procedurale për iniciimin e kontesteve në procedurë administrative/civile; dhe më pas, (ii) ka aplikuar të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

Në këtë kontekst, Aktgjykimi sqaron që sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vlerësimi nëse si rezultat i interpretimit/aplikimit të afateve procedurale të përcaktuara në ligjet e aplikueshme mund të jetë cenuar e drejta e qasjes në drejtësi, e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duhet t'i nënshtrohet

osporene u konkretnom slučaju, presuda Suda ocenjuje navode podnosioca zahteva koji se odnose na povredu njegovog prava na pristup pravdi kao rezultat odluka redovnih sudova, na osnovu kojih je pokretanje upravnog spora protiv osporenih odluka TSK-a proglašeno neblagovremenim. U tom kontekstu, presudom su najpre razrađena (i) opšta načela u vezi sa pravom na pristup pravdi razvijena sudskom praksom Evropskog suda za ljudska prava i Suda, sa naglaskom na sve one slučajeve u kojima je razmatrano pitanje da li je bilo ili nije bilo povrede prava na pristup pravdi kao rezultat tumačenja/primene procesnih rokova za pokretanje sporova u parničnom postupku; a zatim (ii) primenio ista na okolnosti konkretnog slučaja.

U tom kontekstu, presuda pojašnjava da prema sudskoj praksi Evropskog suda za ljudska prava, ocena da li je kao rezultat tumačenja/primene procesnih rokova utvrđenih u važećim zakonima možda povređeno pravo na pristup pravdi, zagarantovano članom 6. Evropske konvencije o ljudskim pravima, mora biti podvrgnuta testu (i) legitimnog cilja; i (ii) srazmernosti. U kontekstu prvog kriterijuma, odnosno legitimnog cilja, sudska praksa Evropskog suda za ljudska prava je dosledna u tome da poštovanje procesnih rokova utvrđenih u važećim zakonima, teži legitimnom cilju valjanog sprovođenja pravde i poštovanja načela pravne sigurnosti. Dok, u kontekstu drugog kriterijuma, odnosno srazmernosti, sudska praksa Evropskog suda za ljudska prava, između ostalog, naglašava da sudovi moraju da izbegavaju kako prekomerni formalizam tako i prekomernu fleksibilnost u tumačenju procesnih rokova propisanih važećim zakonima sa ciljem zaštite načela pravne sigurnosti. U principu, i kako se detaljno objašnjava u presudi, Evropski sud za ljudska prava je utvrdio povredu prava na pristup pravdi u kontekstu tumačenja procesnih rokova utvrđenih važećim zakonima, uglavnom onda kada su nadležni javni organi izračunali procesne rokove za pokretanje tužbi i/ili podnošenje žalbi od trenutka donošenja odluke, a ne od trenutka objavljivanja osporenih odluka, čime su dotičnim strankama onemogućili i/ili naneli nesrazmeran teret da

testit të (i) qëllimit legjitim; dhe (ii) proporcionalitetit. Në kontekst të kriterit të parë, përkatësisht qëllimit legjitim, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është konsistente në atë se respektimi i afateve procedurale të përcaktuara në ligjet e aplikueshme, ndjek qëllimin legjitim të administrimit të duhur të drejtësisë dhe respektimit të parimit të sigurisë juridike. Ndërsa, në kontekst të kriterit të dytë, përkatësisht proporcionalitetit, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndër të tjera, thekson që gjykatat duhet të shmangin edhe formalizmin por edhe fleksibilitetin e tepruar në interpretimin e afateve procedurale të përcaktuara në ligjet e aplikueshme me qëllim të mbrojtjes së parimit të sigurisë juridike. Në parim, dhe siç sqarohet detajisht në Aktgjykim, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka konstatuar shkelje të së drejtës për qasje në drejtësi, në kontekst të interpretimit të afateve procedurale të përcaktuara në ligjet e aplikueshme, kryesisht atëherë kur autoritetet përkatëse publike kanë llogaritur afatet procedurale për iniciimin e padive dhe/ose ushtrimin e ankesave nga momenti i vendimmarrjes dhe jo nga ai i publikimit të vendimeve të kontestuara, duke u pamundësuar dhe/ose vënë barrë joproporcionale palëve përkatëse që të ushtrojnë të drejtat e tyre të përcaktuara në ligjet e aplikueshme. Në anën tjetër, duke mos konstatuar shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në kontekst të cenimit të së drejtës në qasje në drejtësi edhe në rastet kur vet autoritetet publike kanë këshilluar gabimisht palët përkatëse lidhur me afatet procedurale për iniciimin e padive dhe/ose ushtrimin e ankesave, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka vënë theks, në parim dhe ndër të tjera, në faktin që palët bartin detyrimin për të vepruar me kujdesin e duhur dhe bazuar në afatet procedurale të përcaktuara në ligjet e aplikueshme, me theks në rrethanat kur ato përfaqësohen në procedurat përkatëse nga përfaqësues të autorizuar.

Përfundimi

Në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës, nuk është kontestuese që padia për iniciimin e konfliktit administrativ kundër vendimeve të kontestuara të KPK-së është

